

# UpDate

SPANOS INDUSTRIES GROUP LATEST NEWS

Apr. 11

## Identiteti i ri i Korporatës SPANOS GROUP prezanton identitetin e saj të ri dhe e lançon te azhornuar, një website i orientuar per klientin.

**SPANOS GROUP** ka lançar kohët kohët e fundit identitetin e tij të ri të shoqërisë. Logoja e re është dizenuar për të përfaqësuar karakter modern, thjeshtësi, dinamizëm dhe vendosmërinë. Slogani **“Të Ndërtosh në Besim”** qëndron për vlerat që kanë qenë gjithmonë gur themeli i shoqërisë.

**DUKE HEDHUR NJË**, sy në të ardhmen, SPANOS GROUP gjithashtu ka ridizenuar faqen e saj të internetit, si një përgjigje direkte ndaj nevojave të sotme të klientëve. Ajo është e favorshme për përdoruesin dhe e lehtë për të lundruar, e pasuruar me përmbajtje të ndryshme dhe karakteristika të përmirësuar.

**TRANSMETIM I VAZHDUESHËM I VIDEOVE**, recensione të fundit të


shtypit, lajme të jashtëzakonshme, pamje të produkteve, pyetje të klientëve janë vetëm disa nga karakteristikat e futura, që paraqet gamën e gjerë të produkteve dhe shërbimeve të SPANOS, duke çuar në një biznes të orientuar më mirë ndaj klientit. Vizitorët mund të gjejnë pershkrime të detajuara për të gjithë produktet, që Spanos ofron, nepermjet te dhenave teknike koresponduese. Website i ri siguron oferta promovionale, produkte te perdorura (me foto te bashkangjitura), pjese kembimi dhe servis. Dhe të gjitha këto janë të disponueshme në gjuhën lokale për çdo filial të shoqërisë.

**FAQJA E INTERNETIT DO TË PËRDITËSOHET RREGULLISHT** në përputhje me produktet e reja dhe të

përmirësuar dhe shërbimet duke iu mundësuar klientëve tanë të jenë të informuar në kohë me të gjitha linjat e reja. Në të njëjtën kohë do t'i sigurojë informacion klientëve të mundshëm për SPANOS GROUP, njohuritë e saj speciale dhe fushat dhe mënyrat e saj të operimit.

**FAQJA E RE E INTERNETIT E SPANOS** është një refleksim i besimit të saj të fortë në përfshirjen personale me klientët nga njëra anë dhe furnizuesit & partnerët distributorë në anën tjetër. Duke pasur në mendje rritjen e biznesit elektronik (e-business), SPANOS përpqet të mbajë një hap me lëvizjen e shpejtë të sotme të marketingut elektronik (e-marketing) dhe operimit online.

Për më shumë informacion vizitoni [www.spanos-group.com](http://www.spanos-group.com)



# SPANOS GROUP

“vë bast dhe fiton”!



**VETËM KOHËT** e fundit dhe në një distancë të shkurtër prej pak kilometrash nga Selaniku, në zonën e Gevgelja, hapí dyert për publikun një kazino/hotel i ri modern me 5 yje: “Princess” është me standarde të larta ndërkombëtare dhe i përket Princess Casinos multinacionale që zotëron 31 kazino në të gjithë botën. SPANOS GROUP ka marrë pjesë në mënyrë aktive në konstruksionin e projektit të ndërtimit duke qenë se totali i betonit të hedhur u prodhuan nga MOBISPA, impianti i betonit plotësisht i lëvizshëm nga SPANOS INDUSTRIES që ishte vendosur në sektorin e konstruksionit.

**DUKE MARRË NË KONSIDERATË CILËSITË** e konstruksionit të standardeve të larta dhe planin me kohë strikte, kontraktuesi Gemma Group, ka zgjedhur MOBISPA-1 ndërmjet një numri impiantesh të ngjashme. Zgjidhja unike fleksibël, teknologjikisht e avancuar dhe super e lëvizshme e MOBISPA-1, e shoqëruar nga gama e plotë e shërbimeve të integruara pas shitjes të SPANOS GROUP, ka siguruar kapacitet të lartë prodhimi, beton të prodhuar të certifikuar dhe së fundmi por jo më pak, shpenzime të minimizuara instalimi, operimi dhe mirëmbajtjeje të kontraktuesit.

**GJASHTË IMPIANTE** super të lëvizshme MOBISPA operojnë sot në Maqedoni, praktikisht duke monopolizuar tregun lokal dhe duke provuar superioritetin e tyre ndaj konkurrencës.

**MOBISPA-1** është i vetmi mikser betoni i lëvizshëm në të gjithë botë me Miratim Evropian si gjysmërimorkio. Fleksibël, i sigurt, me kosto efikase në transportimin dhe operimin e tij, MOBISPA-1 është zgjidhja ideale me kualitet të lartë, veçanërisht për zonat e largëta.

**MIKSERI I BETONIT TË LËVIZSHËM MOBISPA-1**, montohet mbi një (1) gjysmërimorkio që plotëson tërësisht rregulloret rrugore në lidhje me dimensionet, fenerët, sinjalet, frenat etj dhe që është plotësisht i unifikuar me mikserin. Mbi këtë vendosen të montuar dhe të lidhur të gjithë sistemet për sa i përket ruajtjes, operimit, peshimit, transportit dhe miksimit dhe çfarëdo tjetër që e bën makinerinë plotësisht të pavarur. Përbushja e plotë e rregulloreve rrugore nuk kërkon lëshimin e një licence të veçantë transporti dhe prandaj ajo çka kërkohet për transportimin nga një terren pune në një tjetër është një traktor i zakonshëm me 2 akse.

**MOBISPA-1, ËSHTË EDHE** e lehtë për t'u transportuar dhe e thjeshtë dhe e shpejtë për t'u instaluar, një fakt që lejon prodhimin e betonit të standardeve të larta në pak orë nga mbërritja e makinerisë në terrenin e punës pa pasur nevojë për përgatitje të veçanta në terrenin e punës, bazamente të veçanta etj.

**MIKSERI I BETONIT TË LËVIZSHËM MOBISPA-1**, është zhvilluar plotësisht si

fillim nga SPANOS Industries S.A. dhe ka marrë patentën në bazë të certifikatës **OBI 2006/0100625**. Gjatë projektimit të mikserit është parashikuar plotësisht që stabiliteti dhe siguria thelbësore të përbushnin tërësisht kërkesat e të dhënave teknike të **DIN 15018**. Cilësia e prodhimit është certifikuar plotësisht sipas **ISO 9001:2008**, çdo mikser mban shenjën e **CE**, që dëshmon përputhjen me rregulloren **2006/42 CEE** në lidhje me sigurinë e makinerisë.

**VEC KËSAJ PËR SHKAK** të faktit që rrjeti rrugor përdoret për qëllime transporti, e gjithë struktura mbulon plotësisht direktivat Evropiane **27/97 EC, 98/12-ECE-R13, 97/28 ECE -R48, 996/64 EC, 2001/43 ECE-R30, R54, R64, 89/297EC** dhe prandaj mund të lëvizë në çdo vend të Bashkimit Evropian.

**MIKSERI ËSHTË I SHOQËRUAR NGA** manual i detajuar i përdorimit dhe mirëmbajtjes si dhe nga një katalog i detajuar i pjesëve të këmbimit në 9 gjuhë. Eliminimi i kohës joproduktive sigurohet nga shërbimi i mbështetjes pas shitjes të SPANOS 24/7, ndërsa shoqëria ofron trajnim të hollësishtëm teorik dhe praktik (me anë të aparatit modelues) për operatorët.

**PËR MË SHUMË INFORMACION** ju lutem vizitoni [www.spanos-group.com](http://www.spanos-group.com) ose shihni filmin përkatës në kanal tonë të YouTube channel në [www.youtube.com/user/spanosgroup](http://www.youtube.com/user/spanosgroup)

## AMMANN ITALY S.P.A.

Kompania SIM S.p.A. u bashkua totalisht me AMMANN Group



**SWISS AMMANN** (Ammann-i Zviceran), një biznes familjar që u themelua në 1869 dhe kaloi me sukses në gjeneratën e pestë, është sot një lider botëror në fabrikimin e komplekseve të prodhimit të asfaltit. Gjatë historisë së tij të gjatë Ammann është specializuar në sigurimin e zgjidhjeve të plota të mbështetura nga garancia dhe besueshmëria. 3400 njësitë e asfaltit të ndodhura në të gjithë botën janë provat e gjalla për cilësinë e produkteve AMMANN.

**SOCIETÀ ITALIANA MACCHINE S.P.A (SIM)**, që është 20 vjet anëtare e Ammann Group, nga

01/01/2011ka ndryshuar emërtimin në Ammann Italy S.p. A. Ky hap strategjik njëson angazhimin e plotë të dy shoqërive, duke përmirësuar shpërndarjen e Ammann Group në tregje të ndryshme në të gjithë botën dhe në përfundimin e pozicionit të Grupit. Shpejtësia e shërbimit të klientëve do të rritet si dhe cilësia e sigurimit të zgjidhjeve të njësuara në fushën me kërkesa të larta të ndërtimit të rrugëve.

**SPANOS ODYSSEAS A.B.E.T.E** mbulon në Greqi gamën e plotë të impianteve të asfaltit nga AMMANN.

## Maliakos-Kleidi

### Spanos siguron përzierjen e asfaltit për autostradën Maliakos-Kleidi



**SPANOS GROUP** është angazhuar edhe njëherë në mënyrë aktive në një projekt tjetër të madh infrastrukture në Greqi. Kjo është autostrada Maliakos - Kleidi, pjesë e autostradës PATHE, me një gjatësi totale prej 230km që po ndërtohet nga Maliakos-Kleidi Joint Venture (MKJV). Shoqëria e përbashkët përbëhet prej disa nga grupet më të mëdha të ndërtimit në Greqi dhe jashtë saj si AKTOR, J&P, ATHINA, AEGEK, HOCHTIEF dhe VINCI.

**SPANOS INDUSTRIES KA PËRFUNDUAR NJË MARRËVESHJE** me J&P AVAX, pjesë e JV të lartpërmendur, për prodhimin e 120.000,00t miksi asfalti. Në kuadrin e kësaj marrëveshjeje u instaluan dy EASYBATCH, impiante asfalti super të lëvizshme nga AMMANN ITALY në zonën e Korinos dhe e përfundoi prodhimin me sukses në gjashtë muaj.

**KY IMPIANT ASFALTI SUPER I LËVIZSHËM ËSHTË** dizenuar dhe zhvilluar nga SIM-AMMANN duke marrë parasysh të gjithë teknologjitë bashkëkohore dhe të dhënat teknike, për të përbushur nivelet më të larta të efi-

kasitetit kërkesat e cilësisë të produktit miksi të nxehtë përfundimtar. EASYBATCH Supermobile kombinon të gjitha karakteristikat e një impianti statik "Tip mikseri" dhe një lëvizshmëri fleksibël të jashtëzakonshme që bën të mundur fillimin brenda disa ditësh.

- Njësi komplet e tipit mikser super e lëvizshme dhe super kompakte me një prodhim deri në 90 ton në orë, e gjitha e montar në dy gjysmërimorkio, dimensionet e të cilave janë të përshtatshme për të udhëtuar edhe në rrugë të ngushta të zakonshme.
- 2 gjysmërimorkiot, gjerësia e të cilave nuk i kalon 3m, përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm për prodhimin e asfaltit, duke përfshirë depozitat e ruajtjes së bitumit dhe karburantit dhe ngrohësin oleotermik. Ato janë të gjithë përbërësit të montuar parapakisht duke përfshirë tubacionet dhe kabëllat elektrike.
- Krikot mekanike me pllaka mbështetëse të lidhura tashmë, lejojnë një pozicionim të shpejtë dhe të lehtë të impiantit në terren. Nuk nevojiten bazamente dhe as vinça.
- Kërkohe vetëm tokë kompakte deri në 1,5

Kg/cm<sup>2</sup> dhe makineria ngarkuese (fadrom) në terren mjafton për të vendosur impiantin në pozicionin e duhur të operimit.

- Impianti dorëzohet i montuar plotësisht në fabrikë para dërgesës dhe si pasojë koha vendosjes është shumë e shkurtër dhe e lehtë për t'u kryer.

**FALË TRANSPORTUESHMËRISË** dhe manovrueshmërisë së lehtë mirëmbajtja e impiantit mund të kryhet direkt në një servis gjatë dimrit duke reduktuar kohën dhe shpenzimet e shërbimit. Dozimi i bitumit në mikser është një parametër vendimtar për cilësinë e produktit përfundimtar dhe influencohet në mënyrë drastike nga luhatjet e temperaturës që ndikojnë në vëllimin e bitumit. Me qëllim që arrihet precizioni më i lartë i mundshëm, SIM adoptoi sistemin e fundit teknologjik në këtë fushë, që është sistemi i dozimit të bitumit ROTAMASS. Ky sistem bazohet në parimin e Coriolis dhe mat peshën e asfaltit të dozuar duke e bërë Easy Batch Supermobile impiantin e vetëm të asfaltit në të gjithë botën të pajisur me këtë sistem.

SPANOS INDUSTRIES S.A.  
THESSALONIKI - HEAD OFFICES  
3rd zone, Square Block 42,  
Industrial Area of Sindos,  
PO Box 63, GR 570 22  
Tel: +30 2310 586600  
Fax: +30 2310 586650  
greece@spanos-group.com

ATHENS  
33rd km Athens - Lamia,  
190 11 Polydendri - Attica  
Tel: +30 22950 23533  
Fax: +30 22950 22869

LIMASSOL:  
SPANOS ODYSSEAS (CYPRUS) LTD  
208, F. Roosevelt Ave.  
3045 Zakaki - Limassol  
Tel: +357 25 662611 & 12  
Fax: +357 25 827970  
cyprus@spanos-group.com

BUCHAREST:  
SPANOS INDUSTRIA SRL  
Drumul Garii Nr 25-35 Otopeni,  
Bucharest  
Tel: +40 021 3524304  
Fax: +40 021 3524303  
romania@spanos-group.com

SKOPJE:  
SPANOS INDUSTRIES DOOEL  
33a/16, Leninova St.  
P.O. Box 462  
Skopje  
Tel: +389 70 393287  
Fax: +389 34325185  
skopje@spanos-group.com

TIRANA:  
SPANOS ALBANIA SHPK  
Autostrada Tirana - Durrës,  
km 7 Kashar, Tirana  
Tel: +355 44 504177  
Fax: +355 44 504176  
albania@spanos-group.com

PRISHTINA:  
SPANOS KOSOVA SHPK  
Magjistralja Prishtine-Gjilan  
km i 2-te, Veternik - 10000 Prishtine,  
Kosovo  
Tel: +381 38602194  
Fax: +381 38602193  
kosovo@spanos-group.com

# Më e mira mbi të gjitha

## Gama e re e shtrueseve te asfaltit Dynapac

**DYNAPAC PO LANCON** një gamë të re makinerish shtrimi të asfaltit me karakteristika të avancuara të dizenuara për t'i bërë thirrje pronarëve, operatorëve dhe skuadrave të shërbimit si dhe për të ofruar përfitime mjedisore.

**GJASHTË MAKINERITË REJATË SHTRIMIT TË ASFALTIT** me një gjerësi pune nga 2 m deri në 14 m, janë prezantuar nga **Dynapac në janar 2011**. Dy shtruesit e kontrolluar në mënyrë të zakonshme F2500C & F2500CS si dhe katër shtruesit e kontrolluar plc (kontrollues logjik i programuar) SD2500C/SD2500CS/SD2550C/SD2550CS janë dizenuar për të përmbushur nevojat e kontraktuesve, komuniteteve dhe shoqërive qiradhënëse në të gjithë botën. Ata do të zëvendësojnë makinat popullore të Dynapac F121C/F141C/SD115C/SD135C/F181C/F182CS.

**KARAKTERISTIKAT MË TË** rëndësishme për t'u theksuar janë platforma e rrëshqitshme e operatorit në seritë SD dhe sistemi i impaktit të sigurt si një opsion për karrocierinë e përmirësuar dhe të sigurt të kamionit. Të gjithë shtruesit kanë opsionin e hinkave më të mëdha dhe më të gjera, konvejerëve më të gjerë dhe helikave më të holla të transmisionit, që çojnë në një transport më të butë materialit në shtrues me më pak veçim dhe rezultate të shkëlqyera shtrimi.

**SECILI NGA MODELET E REJA** punon me një motor turbo-diesel me ftohje me ujë Cummins QSB 6.7. Fuqia e përshtatshme është 110kW ose 129kW në 2200 rpm për F2500 C/

F2500 CS; 129W ose 149kW në 2200 rpm për SD2500 C dhe SD2500 CS, dhe së fundmi 176 kW ose 194 kW në 2200 rpm për SD2550 C/SD2550 CS. Modelet e reja - të pajisura me mekanizëm sheshimi - kanë një peshë totale 18.5t deri 19.6t. Numri total i lidhjeve hidraulike është reduktuar ndjeshëm. Kjo redukton gjithashtu riskun e rrjedhjeve.

**GAMA E RE E SHTRUESVE ËSHTË** dizenuar për të arritur rezultate shtrimi të cilësisë së lartë nëpërmjet karakteristikave operationale si transmision kryesor i kontrolluar elektronikisht. Njëra nga mënyrat për të arritur shtrim të cilësisë së lartë është të përmirësosh ergonominë, duke siguruar që operatorët të kenë vizibilitet të vazhdueshëm të operimit dhe akses të lehtësuar të kontrollet. Të gjitha makineritë kanë vizibilitet të plotë në të gjithë zonat e punës (hinka, helika dhe sheshuesi).

**NJË KARAKTERISTIKË** kyçe nga Dynapac është vendimi për të pajisur motorët me eco-mode, që prodhon më pak zhurmë, veçanërisht në platformën e operatorit. Pra zhurma mbahet e ulët nëpërmjet përdorimit të një ventilatori ftohës të drejtuar nga temperatura të transmetuar në mënyrë hidraulike, që operon vetëm kur është e nevojshme. Përmirësimet e efikasitetit kanë kursyer disa kW në operimin e një modeli tip në gamë, me përmirësime konsekuente në shpenzimet e vazhdueshme dhe zhurmën.

Për më shumë informacion ju lutem vizitoni [www.dynapac.com](http://www.dynapac.com).

